

Tregtia e jashtme e Shqiperise

Veshtrim i pergjithshem

Tregtia e jashtme e Shqiperise, ne vitet e fundit eshte karakterizuar ne pergjithesi nga ndryshime thelbesore, duke shkuar drejt liberalizimit per rrjedhoje, duke sjelle ndryshime edhe ne treguesit kryesore te saj.

Ekonomia shqiptare, vitet e fundit ka mundur te siguroje stabilitet nga pikepamja e treguesve makro-ekonomike, edhe gjate periudhes se krizes ekonomike globale. Konkretisht, per vitin 2010 rritja reale e GDP-se eshte vleresuar 4.1%. Volumi tregtar i Shqiperise ne vitin 2010 ka nje rritje te konsiderueshme ne masen 20% krahasuar me vitin 2009. Per vitin 2010 volumi i pergjithshem tregtar eshte ne raportet 74.9% importe dhe 25.1% eksporte dhe krahasuar me nje vit me pare ne vitin 2009 raportet e volumit te pergjithshem tregatar ishin importe 80.7% dhe eksportet 19.3%. Ne vitin 2010 eksportet jane rritur ne masen 56% krahasuar me nje vit me pare, po ashtu edhe importet jane rritur ne masen 11.4%. Duke analizuar tendencen e eksporteve ne 5 vitet e fundit, shohim qe ajo eshte gjithnje ne rritje ne vlere absolute.

Ecuria e eksporteve luan nje rol te rëndesishem ne prespektiven dhe zhvillimin e qendrueshem te ekonomise se vendit, si dhe ne bilancin tregtar me qellim qe ti bej balle edhe konkureses nderkombetare. Ritmi i rritjes se eksporteve ne vite eshte nje tregues i rëndesishem, mbi ecurine e te cilit mund te gjykojme per stabilitetin dhe qendrueshmerine e ekonomise ne pergjithesi, si dhe te aftesise se saj per te konkurruar ne tregjet nderkombetare por qe reflekton ne menyre direkte dhe shume te ngushte edhe konjuktoren nderkombetare.

Eksportet e Shqiperise per vitin 2010, kane patur nje rritje te konsiderueshme krahasuar me vitin 2009, duke qene sinjal mjaft pozitiv, qe u shoqerua me rritjen e investimeve dhe nje rigjallërim e fuqizim te ekonomise shqiptare. Faktet e ketij viti theksojne dhe nje here qe politikat liberalizuese dhe reformat e shumta ekonomike te ndermarra mund te ndryshojne ritmin nga negativ ne pozitiv te cilat tregojne ecurine e ekonomise se vendit tone por dhe ndikimin e saj nga faktore te jashtem.

Raporti i eksportit me prodhimin e brendshem bruto ose prirja e ekonomise shqiptare per te eksportuar eshte nje tregues tjetër i evidentimit te qendrueshmerise se eksporteve. Per vitin 2010 ky tregues eshte 12.2 % qe eshte tregues relativisht i kenaqshem ne veçanti per vitin e fundit. Ky tregues ka arritur nivelin me te larte krahasuar jo vetem me vitin 2009 por edhe nivelin me te larte krahasuar me 5 vitet e fundit.

Sektoret potenciale te produkteve per eksport vazhdojne te mbeten ato qe tashme quhen sektore tradicionale dhe nder to sektori i Tekstileve dhe veshjet e kembeve mbeten nje potencial i konsiderueshem per te rritur shifrat e eksportit. Pavaresisht niveleve te rritjes jo shume te larta, ato mbeten nje potencial i madh, ne veçanti per rritjen e prodhimit te produkteve. Ky sektor ze 34.6% ndaj totalit te eksportit duke u renditur ne vend te pare

Zhvillimet e tregtise se jashtme perbejne nje komponent te rëndesishem te zhvillimeve te pergjithshme ekonomike ne teresi dhe te sektorit te jashtem ne vecanti. Tregtia e jashtme eshte vecanerisht me rëndesi kritike per ekonomite e dimensioneve te vogla si vendi yne.

Tashme ekonomia e vendit tone eshte bere pjese perberese e nismave per liberalizimin dhe

lehtesimin e tregtise ne nivel rajonal dhe me gjere. Pjesemarrja aktive ne keto nisma shton mundesite e ekonomise sone per t'u specializuar dhe njekohesisht kerkon angazhime ne drejtim te rritjes se konkurrueshmerise. Treguesit e tregtise se jashtme, per çdo vend shprehin shkallen e zhvillimit ekonomik dhe te perfitimit te ndersjelle, per kete arsye analiza dhe vleresimi i treguesve te shkembimeve tregtare merr nje rendesi te veçante

Eksportet nga regjimi me perpunim aktiv (Ri-eksport -Fason)

Per vitin 2010 eksportet e fasonit ne vlere absolute jane rritur por rezultojne me renie krahasuar me vitin 2009 dhe vijojne te zene peshen me te madhe te totalit te eksportit te mallrave. Eksporti me regjim te perpunimit aktiv (material porositesi per ri-eksport) per vitin 2010 arriti ne 619 mln/€, (824mln/\$), ose 53 % te totalit te eksportit me nje renie prej 10.4% kundrejt vitit 2009.

Ne gamen e eksporteve te artikujve me regjim nga perpunimit aktiv, ne vitet e fundit verehet nje zgjerim te artikujve, qe realizohen me kete forme, krahas artikujve te tekstilkonfeksioneve, kepuçarise dhe peshku açuge jane realizuar edhe shume artikuj te tjere si; te brendeshme te kafsheve te therura, molusqe, krustace, produkte me origjin shtazore, pergatitje zarzavatesh, artikuj plastike, druri, letra dhe kartoni, hekuri dhe çeliku, artikuj prej metali, makineri dhe paisje elektro-teknike dhe kompjuterike, orendi dhe paisje kirurgjikale, lodra femijesh etj.

Eksportet sipas vendeve destinacion

Sipas destinacionit edhe per vitin 2010 ne pjesen me te madhe te tyre, eksportet e mallrave kane shkuar drejt vendeve te BE-se, duke arritur ne 819 mln/€ ose 70.2 % te totalit te eksporteve dhe me nje rritje prej 32% kundrejt vitit 2009. Peshen me te madhe te artikujve drejte BE-se ne eksport shkojne kryesisht drejt Italisë, Greqisë, Gjermanisë, etj.

Ndersa, grup shteti tjetër i cili mbetet teper domethenese jane edhe eksportit drejt vendeve te rajonit, me te cilat Shqiperia ben pjese ne marreveshjen e tregtise se lire (CEFTA). Per vitin 2010 eksportete drejt ketyre vendeve arrihen ne 119 mln/€ (ose 10.2% e totalit te eksportit) me nje rritje prej 27% ndaj vitit 2009. Ndersa me vendet e EFTA-s, kemi nje rritje te larte gjate vitit 2010 duke arritur ne vleren 49.6 mln/€ (ose 4.2% te totalit te eksportit). Vendet qe mbajne peshen me te madhe ne eksportet shqiptare jane Italia me 50.9%, kosova 6.1 dhe Turqia 6% dhe Greqia me 7.4% etj.

Shkembimet tregtare me BE

Nga 1 Dhjetori i vitit 2006, ne kuader te MSA-se, ndermjet Shqiperise dhe Bashkimit European eshte ne zbatim marreveshja e tregtise se lire. Kjo marreveshje synon ne integrimin gjithnje e me te plote te Shqiperise me BE-ne, nderkohe qe ky grupim eshte partneri kryesor tregtar dhe ekonomik i vendit tone. Marreveshja e tregtise se lire ndermjet BE-se dhe Shqiperise, e cila shtrihet ne nje periudhe tranzitore 10-vjeçare, e ndare ne dy faza nga 5-vjet, konsiston ne eliminimin gradual te tarifave doganore, eliminimin e te gjitha kufizimeve sasiore dhe masave te tjera me efekt te njejte, perafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit tregtar me "acquis

2

communautaire” dhe eliminimin e diskriminimit fiskal për të gjitha llojet e taksave dhe tarifave që zbatohen në territoret e të dy paleve. Në këtë marrëveshje, përcaktohet eliminimi progresiv i tarifave doganore për artikujt jo-ushqimorë me origjinë nga vendet e BE-së, për një periudhë 5-vjeçare dhe hiqen të gjitha kufizimet sasiore apo masat me efekt të njëjta, ndërsa Komuniteti eliminon të gjitha tarifat doganore për produktet industriale me origjinë nga Shqipëria, si dhe Shqipëria duhet të kryejë rregullimet e zbatueshme për hekurin e çelikut në parashikuar në protokollin.

Nga krahasimi i treguesve realë të tregtisë, ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së, para dhe pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje, rezultoi se në vitin 2010 kemi një rritje prej 32 % të eksportit krahasuar me vitin 2009 si edhe importet me vendet e BE-së në 2010 kanë një rritje prej 6.8% më shumë se viti 2009. Ndërsa volumi tregtar i vitit 2010 krahasuar me vitin 2009, ka një rritje prej 11.2%. Por rritja e volumit tregtar, për një vijueshmëri me BE-në është rezultat i rritjes së njëkohshme të eksporteve dhe importeve me këto vende. Gjithashtu duhet të theksojmë se eksportet me vendet e BE-së në vitin 2010 rezultojnë 70.2% të eksporteve në total si edhe importet në vitin 2010 rezultojnë 64.5% në total. Vlen për tu përmendur që partnerët kryesorë nga vendet e BE-së janë Italia, Greqia etj.

Shkëmbimet tregtare me vendet e rajonit

Marreveshja e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA)

Kjo marrëveshje, e cila ka filluar implementimin që nga maji i vitit 2007 dhe është rrjedhojë e marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë mes vendeve të rajonit, të Evropës Juglindore. Kjo marrëveshje mbështetet në parimet e OBT-së dhe ato të levizjes së lirë të mallrave dhe dhenies së shërbimeve sipas përcaktimeve të MSA-së. Marrëveshja e vetme e tregtisë së lirë CEFTA, karakterizohet nga një nivel i lartë i liberalizimit, lehtësimit të procedurave, thellimin e bashkëpunimit doganor, harmonizim rregullash e procedurash për zbatimin e rregullave teknike, masave sanitare fitosanitare në tregti, etj.

Treguesit realë të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë dhe vendeve të tjera anëtare të CEFTA-s, kanë pësuar një ndryshim mjaft të dukshëm pas zbatimit të CEFTA-s duke zënë në vitin 2010 një peshe specifike prej 9.4 % të shkëmbimeve tregtare nga 5.5 % që zinte në vitin 2006, si edhe nga 7.7% që zinte në vitin 2009. Në vitin 2010 kemi një rritje të eksportit nga vendet e CEFTA-s prej 26.5% krahasuar me vitin 2009, si edhe një rritje të importit në masën 46.3% krahasuar me vitin 2009.

Treguesit e shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me TURQINË

MTL-ja me Turqinë: Gjatë vitit 2010, Turqia është renditur partneri i tretë kryesor i Shqipërisë, pas Italisë, Greqisë dhe Kosovës, dhe shkëmbimet tregtare me Turqinë në përgjithësi kanë njohur rritje të vazhdueshme. Nisur nga niveli i shkëmbimeve tregtare, nga marrëdhëniet ekonomike e më gjera të Shqipërisë me Turqinë, si dhe të marrëdhënieve tregtare të Turqisë me BE-në dhe vendet e rajonit, më 22 dhjetor 2006, u nënshkrua në Tiranë, marrëveshja e tregtisë së lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, e cila ka filluar zbatimin nga 1-Maj 2008. MTL-ja me Turqinë është e përafërt me atë me BE-në për tregtimin, ku produktet industriale me origjinë nga Turqia do të kenë një reduktim

te tarifës doganore në mënyrë të përshkallëzuar në një periudhë tranzitore prej disa vitesh, saktësisht deri në vitin 2012, ndërsa për produktet industriale me origjinë shqiptare ka një trajtim asimetrik në favor të produkteve shqiptare. Për produktet bujqësore dhe të peshkimit janë marrë parasysh interesat e specifikat për këto produkte, për të cilat janë vendosur në MTL masa të veçanta e specifike në eksport dhe import. Si në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, ashtu dhe në të gjithë marrëveshjet e tregtise së lirë me vendet e rajonit, por edhe në MTL-në me Turqinë është pranuar të zbatohen rregullat e origjinës preferenciale të BE-së.

Turqia për vitin 2010 ka zënë 5.7 % të totalit të shkëmbimeve tregtare ose një vlerë absolute prej 266.2 mln/€. Importet për vitin 2010 nga Turqia kanë qenë në masën 5.6% të totalit të importeve, si edhe Exportet kanë qenë në masën 5.9% të totalit të eksporteve.

Shkëmbimet tregtare me EFTA-n

Shqipëria edhe në kuadër të integritimeve të tjera tregtare, rajonale, me BE-në dhe Turqinë, ka përfunduar MTL-ja edhe me vendet anetare dhe Sekretariatit të EFTA-s. MTL-ja me vendet e EFTA-s, respekton parimet e OBT-së, të MSA-së me BE-në, si dhe shumë elemente të CEFTA-s. etj.

Niveli real i shkëmbimeve tregtare me vendet e EFTA-s është gjithnjë e në rritje dhe për vitin 2010 shkëmbimet tregtare kanë përbërë 2.3 % të volumit tregtar të Shqipërisë. Eksporti 4.3% ndaj totalit të eksportit dhe Importi EFTA 1.6% ndaj totalit të importit. Ndërsa në krahasim me 2009 eksporti është rritur në vlerë absolute 40.315 në mil. Euro ose është rritur 4.3 here më shumë. Eksporti kryesor realizohet me Zvicrën, ku zë 4.2% të të gjithë eksportit me vendet e EFTA-s

Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë

Mars 2012